



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PARË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **22.01.2021(e Premte)**, në zyrën e konferencave ne objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, media të shkruara dhe elektronike, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër të rregullt të KPF-së për këtë vit. Uroj që të kemi një vit të mbarë, pasi që është seanca e parë më lejoni të uroj një vit të mbarë. Desha të ju njoftoj se të gjitha aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem? Nëse nuk ka, për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2020.
3. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e propozim vendimi për emërtimi e bibliotekës publik komunal me emrin e publicistit dhe kritikun letrat, z.Ramadan Musliu.
4. Shqyrtimi i planit vjetor dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Vitisë 2021-2023.
5. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës të KKSBB-së për vitin 2021.
6. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e propozim vendimi për caktimi e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës se Vitisë për vitin 2021.
7. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021.

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutem?

z.Jakup Demiri: Në muajin e kaluar ne e kemi pasur një propozim vendim, edhe në këtë mbledhje nuk e kam pru, që kemi pasur me u dakordu, që me mbajtur një takim rreth ndarjes së një shume të caktuar për bizneset vendore apo kryesisht biznese familjare. Unë po e shoh edhe te procesverbali ku shkruan këtu: “në rregull, unë e terheqi tani këtë propozim vendim”. Këtë kisha pas dëshirë me rregulluar, se ne u dakorduam që te diskutojmë rreth kësaj pike.

z.Bekim Azizi: Edhe ne sukur tha Jakupi, jemi pro por ishte problem, se ishte buxheti pa miratuar, se ishte muaji dhjetor dhe nuk ka pasur mundësi dhe ka mbetur për këtë vit. Edhe këto ftesa ju kisha lutë që t'i shkruajmë mirë, se kur e shikojsa materiali në vitin 2020.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër rreth rendit të ditës? Nëse nuk ka e qes në votim rendin e ditës. Konstatohet se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa

A ka dikush rreth rendit të ditës, përveç asaj që e cekim ma herët Jakupi? E qes në votim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2020

Ja kaloj fjalën drejtorit.

z.Ibrahim Rama: Ekzekutimi i buxhetit të vitit 2020, i cili shihet se në bazë të pasqyrave financiare është harxhuar në bazë të parametrevave të planifikuara në buxhetin e vitit 2020, në total për vitin 2020 kemi pasur alukim të mjeteve në shumën prej 12 milion 624 mijë euro. Nga këto mjete janë shpenzuar 12 milion e 548840 euro, apo shprehur në përqindje kemi shpenzim të buxhetit 99.4%. Struktura e brendshme e shpenzimit të buxhetit, aty dihet që janë pesë kategori të cilat janë shpenzuar: për paga dhe mëditje 99.99%; për shërbime dhe mallra 97.38%; shpenzime komunale 100%; subvencionet 94.60%; dhe investimet kapitale janë 9.48%. Kjo ishte në pika të shkurtra, për ma shumë, materialin e keni marr me kohë, për pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion të ju ndihmojë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Të faleminderit drejtor, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm.

z.Ekrem Abazi: Kisha filluar të të hyrat 83%, besoj se u bë një punë e mirë kur e ke parasysh se këtë vit jemi përball me pandeminë. Shpenzime buxhetore 99.40 %, shumë mirë që është bërë ky shpenzim, por mua nuk po më pëlqejnë afatet kohore të shpenzimit të tyre. Te pagat nuk kemi qe diskutojmë, p.sh.: shërbime dhe mallra janarshtator janë shpenzuar 924 mijë euro, ndërsa janar – dhjetorë 1 744444 euro. D.m.th vetëm për tremujorin e fundit janë shpenzuar rreth 800 mijë euro. Subvencionet janar- shtator 80 mijë e 488 euro, janar – dhjetor 251 mijë e 600 euro. D.m.th për tremujorin e fundit kemi 171 mijë euro. Te investimet kapitale janar – shtator 1 milion 214 mijë 572 euro, ndërsa janar – dhjetor mbi 2 milion euro. Diferenca 1 milion e 402 mijë e 557 euro. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, 925 euro; shpenzimet e telefonisë fikse 9300 euro, mobile 48452 euro janë blerë prej muajit tetor, a deri në fund të shtatorit s'ka pas blerje hiq. Pajisje të trafikut për 9 muaj janë blerë 46 mijë euro, a deri në muajin e 12-të 172 mijë euro. Pajisje tjera 107 mijë euro, 32 mijë janë blerë vetëm prej muajit të nëntë. Furnizim me ushqim dhe pije 81 mijë euro, furnizimi me lëndë djegëse 154 mijë e 843 euro 72 mijë kanë qenë deri në muajin e nëntë, kur i pjestojsha me 40 euro dalshin 4 mijë metra dru. Këtu me siguri 1 mijë metra dru janë ma pak. Derivatet e veturave 34 mijë euro, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 21 mijë euro kanë qenë, a në fund është bërë 37 mijë e 270 euro ka kushtu mirëmbajtja e automjeteve, mirëmbajtja e rrugëve lokale 187 mijë euro me qenë para te juajat nuk kish kushtuar kaq, por janë të komunës. Zyrës së Kryetarit i kanë tepruar subvencione 11 mijë euro. Nuk është dashtë me i tepruar fare subvencionet, u dashtë me i harxhuar 100%, se kemi qenë në vite të pandemisë. Pajisje të trafikut, pagesë nga zyra e kuvendit komunal, pse mu ba pagesë, se ato mjete ndahen për kuvendin komunal e jo për pajisje të trafikut. Te shëndetësia kanë tepruar do pare, mallra dhe shërbime, kulturë, rini dhe sport, shërbime dhe mallra kanë tepruar pak. Te arsimit janar-shtator, për shërbime dhe mallra janë harxhuar vetëm 152 mijë euro, a fëmija nuk kanë pasur maska, as dezinfektues, as asgjë. A janar – dhjetor janë harxhuar 500 mijë euro, shërbime dhe mallra te arsimit, donacionet 16 mijë e 80 euro, investimet kapitale 370 mijë euro; Viti - Beguncë, rregullimi me zhavorr 146 mijë euro. Po e marr një shembull, në fshatin tim që është fshati ma i varfër i keni investuar 14 mijë euro me zhavorr. Te asfaltimi i rrugëve afër 1 milion euro, saktë janë shtruar 960 mijë euro. Asfalt në Komunën e Vitisë, në Stubëll u shtruar asfalt, por është masakruar ajo rrugë dhe këtë vit kanë shkuar ja kanë lidhur varrat se është qarë asfalti. Hartimi i projekteve, 58 mijë euro. Edhe këtu Florenti pa i shti hundët në çdo vend nuk e lenë, se me siguri po goditet mirë me dikan dika këtu. Këtu dikush është tu keqpërdor sa është tu mund, po edhe allahu nuk ka me ju fal dine këtë. Bashkëpunimi për këtë shtëpinë e famshme këtu, pse janë të

shkruara 29500 euro, me krejt qe e ceka janë harxhuar 2 milion e 677 mijë e 174 euro. Veç po ju thamë se këto mjete me i pas të vetat edhe mi harxhu si duhet ish ba Paris.

z.Jakup Demiri: Ma së pari materialin e kam marr pardje dhe nuk kam mund me u përgatit realisht, kur e kam parë dje në mëngjes që e kam materialin, por po lidhem pak, pjesën tjetër e la për kuvend të shpenzimet e udhëtimit brenda vendit. Drejtor, transporti i nxënësve 10 mijë euro, drejtor nuk e di për cilët nxënës është bërë ky transport. Shpenzimet e telefonisë fikse janë 9300 euro, po me duket se janë shumë. Te arsimit shpenzimi i organizimit të trajnimeve nëpër shkolla 14658 euro: ku janë mbajtur ato trajnime dhe çfarë trajnime behet fjalë? Shërbime kontraktuese, për shërbime të veçanta është afër 100 mijë euro: a ka njëmend komuna nevojë a qe është puna e tyre, mirëmbajtja e objekteve 148 mijë 356 euro nuk e di cilat objekte janë pastruar mirëmbajtja e auto rrugëve lokale 141 mijë e 557 euro. Po më duket se është shumë e madhe për pastrim dhe për mirëmbajtje të këtyre rrugëve dhe shesheve. Riparimi i rrugëve 45 mijë euro, këtë nuk e shoh ku me ditë sa problem.

z.Bekim Azizi: Unë kërkoj te shpenzimet vjetore që janë për te kontratat në vepër që janë me na I sjell me emra cilat janë obligimet, sepse nuk janë te shkruara këtu. Tash tu e dit se keni obligime gjyqësore, se dihet se një pjesë i kanë fituar lëndët, për pagën jubilarë kemi diku 23 raste që I kanë fituar lëndët, a keni naj shifer që ju ka ardhur juve që keni obligime edhe kisha kërkuar një material shërbime dhe mallra vetëm në arsim që janë shpenzuar, e të tjerat nuk po kyqem ma shumë, por ishalla janë kryer këto punë që janë paguar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Para se me ja kaluar fjalën drejtorit, ishte një pyetje te Zyra e Kuvendit 3129.70 euro, pajisje të trafikut, po them se janë mjete të cilat kanë tepruar dhe për mos me shkuar në suficit, na ja kemi qitur Drejtorisë së Inspeksionit që ka pasur mungesë të mjeteve për me ba pagesë këtë shumë të cekur ma lartë, d.m.th kanë qenë mjete që i kanë tepruar kuvendit komunal. Tash ja kaloj fjalën drejtorit që të paraqitet rreth pyetjeve që parashtruan anëtarët e KPF-së.

z.Ibrahim Rama: Po filloj prej pyetje të fundit, ndërtimi i sheshit. Ne edhe ma herët e kena planifiku projektin, por nuk kemi pas mjete financiare, por vitin e kaluar e kemi fituar grandin e ministrisë së pushtetit lokal 154 mijë euro dhe kemi participuar me 40 mijë euro, gjithsej 194 mijë euro i kemi bërë bashkë dhe e kemi paguar në total projektin, kaq ka kushtuar. Disa pyetje të arsyeshme edhe spjegimi duhet me qenë interesant, se buxheti është i qytetarëve. Sa ma shumë mundohemi me spjegu aq ma mirë është. Ishte një kompliment prej Ekremit, për të hyrat. Unë me të thanë të drejtën kam prit ma shumë. Na çdo vit si drejtori e bëjmë planin dinamik, se na s'mund me i prit krejt mjetet me na ardh në janar. Ne i ndajmë dhe i bëjmë kërkesat në bazë të kërkesave të drejtorive. Sa i përket investimeve kapitale, problemi është edhe te Zyra e Prokurimit, shembull ky projekt paguhet ne 4 faza, po ka prej tyre qe i lënë në fund me marr pagesën dhe na del qe tre muajt e fundit janë bërë pagesa ma shumë. Ishte te subvencionet një pyetje për DKRS, po ju them se ajo nuk ka pas drejt ne kohë pandemie me ba thirrje për subvencione, por nuk është shumë problem, se ata mundemi me bart për vitin e ardhshëm për muzeun ishte një pyetje, është një projekt me Bashkimin Evropian, 15 mijë euro i ka dhanë Bashkimi Evropian, 14 mijë e 500 i kemi dhanë ne si participim, gjitha procedurat i ka kry Bashkimi Evropian. Kontratat mbi vepër, këtë pyetje e kërkoj Bekimi dhe si informatë shtesë do ta kesh në seancën e radhës. Disa obligime që kanë të bëjnë me kontratën kolektive në mënyrë ligjore komuna e ka për obligim me i krye, na nuk i kemi kry prej vitit 2018, nuk ka pasur buxhet me ligj ju takojnë të gjithë atyre punëtorëve, kurse për pjesën kur është i interesuar një asamblist apo një qytetar nuk kam asnjë problem me analizuar një dukuri, p.sh.: shpenzimet e udhëtimit brenda vendit. Furnizimi me dru, kjo është bërë përmes tenderit. Unë tash nuk mundem me trajtuar me kerku landen atje. Krejt kërkesa është bërë për furnizim me dru nga Drejtoria e Arsimit, këto firma kanë konkurruar. Kjo ka qenë sasia edhe ky është fituesi. Jakupi e beri një pyetje për shpenzim të mbeturinave. Ishte një tjetër telefonia fikse 9305 euro, ato janë shpenzuar janë paguar. Ishte një tjetër pagesë për trajnime. Kjo është bërë një pagesë, një obligim që kemi mbetur ka qenë bashkëfinancim me Komunën e Likovës. 48 mijë euro furnizim me inventar, që është bërë nëpër drejtori, që janë bërë në vitin 2020. Pajisje trafiku, kjo është shenjzimi i rrugëve 148 mije euro; pastrimi i objekteve të komunës dhe ndërtesave, edhe kjo është projekt në vete që nuk është një pozicion, por projekti është bërë në vete ka bërë punë që e ka fituar këtë. Edhe te pastrimi i rrugëve që ishte një pyetje 148 mijë euro, me të thanë të drejtën

këto shërbime janë prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pa ma shumë këto bëjnë pjesë pastrimi i rrugëve, parqeve që i kryen shërbime komunës. Kjo ishte, u mundova me ju përgjigj në pyetjet që parashtruat.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor, a ka dikush ndonjë pyetje shtesë ju lutem?

z.Ekrem Abazi: Edhe diçka pata te arsimit, mirëmbajtja e ndërtesave 22370 euro: cilat janë ato?

z.Jakup Demiri: Kisha një pyetje, shpenzimet e udhëtimit dhe transporti i nxënësve, më interesoj me ditë e vitin e kaluar për Debeldeh thoshin nuk kemi drejtë. Edhe në shkollë të Smirës nuk keni pasur dezinfektues. Edhe qetu shpenzimet e telefonisë fikse, kisha pas dëshirë me i pa. Mirëmbajtja e autorrugëve lokale, pastrimi rrugëve dhe shesheve. Edhe këtu kisha pas qef me pa një shpenzim të detajuar. Po lidhet me këtë, vitin e kaluar e kemi pas një dokument pastrimi dhe mirëmbajtja gjitha varrezave në Komunën e Vitisë 200 mijë euro. Asnjë varrezë nuk është mirëmbajtur.

z.Ibrahim Rama: Edhe diçka! Këtu që ka shpenzime në drejtoritë mos u habitni ku ka naj shpenzim kontrast me drejtorinë. Për këtë pyetje që bere, unë e analizoj dhe për kuvend do te jap një përgjigje. Me ligj kemi të drejtë t'i mirëmbajmë gjitha varrezat në Komunën e Vitisë, por në mungesë të mjeteve financiare dhe nuk kemi asnjë shumë për mirëmbajtje. Ti mundesh mi marr fakturat edhe me pa.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor!

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për emërtimi e bibliotekës publike komunale me emrin e publicistit dhe kritikun letrat z. Ramadan Musliu

Është një propozim që na ka ardhur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe me propozim të shoqatës së shkrimtareve të Komunës së Vitisë. Po ta kaloj fjalën drejtor.

z.Milot Lala: Neve na ka ardhur një kërkesë për emërimin e bibliotekës me emrin e Ramadan Musliut, dhe ne si drejtori e kemi sjellë këtë propozim vendim para juve. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje jam ne dispozicion tuaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem? Pasi jemi me konsensus të plotë për këtë propozim vendim, mua më mbetet që ta qes në votim, që t'i rekomandojmë kuvendit që ta merr miratimin. Konstatoj se me vota të të gjithëve shkon në kuvend për miratim.

Si pikë tjetër te rendit të ditës kemi:

4. Shqyrtimi i planit vjetor dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm në Komunën e Vitisë 2021-2023

Ja kisha kaluar fjalën përgjegjësit të auditimit

z.Fevzi Mehmeti: Shqyrtimi i planit vjetor dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm në Komunën e Vitisë 2021-2023. Ne kemi paraparë për këtë kohë me i bërë 15 aktivitete. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush?

z.Bekim Azizi: Drejtor, ky plan vjen veç ne KPF, mirëpo mua më intereson, a e ke ndonjë raport të auditimit, se e kam kërkuar edhe viteve të tjera nuk ma keni sjell asnjëherë.

z.Fevzi Mehmeti: Në bazë të ligjit, Zyra e Auditimit i raporton komitetit të auditimit, që është i emëruar nga kryetari i komunës dhe kryetarit të komunës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Me ju thanë të drejtën ne e kemi debatuar nëpër takime që i kemi pasur me organet relevante, si me MAPL-në dhe të tjera. Naj kanë sugjeruar këtë që po e thua ti.

z.Ekrem Abazi: Ti je ekspert për këtë lami, a ke pas rast, se një punëkryesi veç dy kamiona zall i ka qit edhe i ka marr paret, e te dikush masi u kry puna edhe ka pas problem me i marr paret.

z.Fevzi Mehmeti: Ne e bëjmë raportin sipas mostrave që marrim edhe me qellu e bëjmë edhe atë auditim, a po shtrohet ajo rrugë a qa po bëhet. Janë komisionet e caktuara që nuk na bëjnë neve me u merr.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin rreth kësaj pike.

Na si pikë tjetër kemi

5. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit të punës të KKSB-se për vitin 2021

Ja kaloj fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Këtu para jush e kemi edhe planin komunal për siguri në bashkësi. Është rregull që përçdo vit me e sjellë. Unë e kam përgatitur edhe raportin, por koka bërë një lëshim teknik, që me lejen e juaj kisha kërkuar që në kuvend.

Kryesuesi z.Naim Pira: E qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Kemi edhe dy pika që janë prej kuvendit të sjellura.

6. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e propozim vendimi për caktimi e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2021

7. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e propozim vendimi për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021

A jeni që edhe këto të shkojnë për kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkojnë për kuvend edhe këto dy pika të rendit të ditës.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
